

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.28/2019	Data: 29.03.2019	

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe nenit 5 nënparagrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndërkomunal, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë:29.03.2019, mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E NISMES SE BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL NË FUSHËN REALIZIMIT TË PROJEKTIT

1. Miratohet Nisma e Kryetarit të Komunës së Istogut për të hyrë në bashkëpunim nderkomunal, për aplikimin pranë BE-së për projekte të përbashkëta.
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet në mes të dy komunave:
 - 2.1 Komuna e Istogut dhe
 - 2.2 Komuna e Klinës.
3. Qëllimi i bashkëpunimit- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e ruajtjes dhe kujdesit të ambientit, Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.
4. AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës së Istogut për të filluar konsultimet me Kryetarin e Komunës së Klinës për përgatitjen e propozim marrëveshjes për bashkëpunim nderkomunal për realizimin e projektit: "Pastrimi i shtratit të Lumit Istog".
5. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna

Nr: 01-039-4 Data: 01-04-2019
 Br: Datum



Kryesuesi i Kuvendit,
Qaush BALAJ